

PROCESVERBAL
nga seanca e 12-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 26.03.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: Dimitar Tanurov, mr. Magdalena Davidova Dovleva, Goran Radunoviq, mr. Arben Saiti, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Z. Petrushevski hapi seancën e 12-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 13:30 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Z. Petrushevski propozoi që Pika 5 „Propozim-qëndimi i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në lidhje me rezultatin nga auditimi (revizioni) i kryer nga revizor i pavarur për vitin 2023“ të jetë Pika 4, sepse ka lidhje me Propozim-raportin vjetor të punës së Agjencisë për vitin 2023, ndërsa „Propozim-udhëzim për transmetuesit për Zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare 2024“ të bëhet Pika 5. Gjithashtu propozoi që Pika 6 „Propozim për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për furnizim të mallit – Pllakë Gravoglas e gdhendur me laser, me vlerë të parashikuar nën kufijtë e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik“ të hiqet nga Rendi i ditës, sepse gjendemi në periudhë zgjedhore dhe nuk është planifikuar në Planin vjetor për furnizime publike për 2024.

Z. Petrushevski deklaroi se propozimet për korrigjimin e Rendit të ditës janë të pranueshme për të.

Këshilli nuk kishte kundërshtim.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota „pro“, miratoi të korrigjuar:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga vazhdimi i parë i seancës së 9-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 20.03.2024.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 11-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 20.03.2024.

3. Propozim-raport vjetor për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023.
4. Propozim-qëndrim i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në lidhje me rezultatin nga revizioni i kryer nga revizor i pavarur për vitin 2023.
5. Propozim-udhëzim për transmetuesit për zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare për 2024.
6. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga vazhdimi i parë i seancës së 9-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 20.03.2024, me tekst siç ishte propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 11-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 20.03.2024, me tekst siç ishte propozuar.

Pika 3

Udhëheqësja e Sektorit për planifik strategjik dhe të drejtat e autorit mr. Magdalena Davidovska Dovleva shpjegoi Propozim-raportin vjetor të punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023. Ajo shpjegoi se në faqen 6, hyrja e Raportit është plotësuar me pjesën që ka dalë si konkluzion nga seanca e kaluar, ku u miratua dokumenti në Draft verzion në lidhje me financimin e Agjencisë nga Buxheti i RMV-së. Në lidhje me pjesën tjetër të përmbajtjes nga Raporti u informua se nuk ka ndryshime të tjera krahasuar me Draftin.

Z. Petrushevski tha se vërejtje që ai ka bërë në lidhje me Draftin janë inkorporuar dhe se vërejtje të tjera për tekstin nuk ka.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim me të cilin është miratuar Raporti Vjetor i punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023, (me Raport për realizimin e planit vjetor për mbikëqyrje programore për vitin 2023 dhe Raport Financiar për realizimin e Planit Financiar për 2023 dhe llogari vjetore me të ardhurat, shpenzimet, kërkesat dhe detyrimet e realizuara për vitin 2023), me tekst siç ishte propozuar.

Agjencia të vepron në pajtim me nenin 8 paragrafi (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23 dhe 55/24) dhe neni 11 paragrafi (2) të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) nr.01-3732/1 datë 29.07.2019.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 4

Z. Trajçevski shpjegoi Propozim-qëndrimin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në lidhje me rezultatin nga auditimi i kryer nga revizor i pavarur për 2023. Ai shpjegoi se kryerja e revizionit(auditimit) nga ana e revizori të pavarur dhe Qëndrimi që duhet të merr Këshilli i Agjencisë në lidhje me Raportin e Auditimit paraqesin detyrim ligjor. Për këtë qëllim është zgjedhur një firmë auditimi, dhe biznes konsalting A&BA GROUP SHPKNJP Shkup e cila ka kryer auditim dhe ka dhënë dy rezerva në lidhje me punën e Agjencisë. Në këtë drejtim është propozuar që Agjencis të pajtohet me mendimin e dhënë në Raportin e Auditimit për 2023, por me dy rezerva, njëra për tokën nën ndërtesën e Agjencisë, vlera e së cilës është futur në bilansin e Agjencisë me rekomandim të Entit Shtetëror të Auditimit. Kjo firmë auditimi edhe më herët ka kryer auditim dhe ka dhënë të njëjtën vërejtje. Më pas Agjencia i'u drejtua Entit Shtetëror për auditim dhe ata u përgjigjën se vazhdojnë të kenë të njëjtin qëndrim, se vlera e tokës duhet të futet në bilancin e Agjencisë. Vërejtja e dytë ka të bëjë me kërkesën e papaguar. Agjencia ka një kërkesë të papaguar prej 1 milion e 652 mijë denarë, po në nivel mujor kryen arkëtim përmes përmbaruesit, që i përgjigjet 30% që i ka si të ardhura debitori Agjencisë.

Z. Petrushevski tha se vërejtjet nga auditimi janë përsëritur nga viti i kaluar. Më pas anëtarët e Këshillit diskutuan gjerësisht dhe zgjodhën variantin si në paragrafin e propozuar. Në bazë të përvojës nga viti i kaluar dhe atë që kishte lexuar në materiale, ai tha se do të mbështesë qëndrimin.

Z. Petrushevski, lidhur me vërejtjen e dytë për kërkesën e papaguar, kërkoi nga udhëheqësi i Sektorit për financa dhe logjistikë që të japë një shpjegim më të detajuar nga aspekti financiar dhe kontabël, çfarë do të thotë të fshihet një borxh, rezervimi, nëse fshihet a mund të arkëtohet, si është rregulli për udhëheqjen e librave.

Udhëheqësi i Sektorit për financa dhe logjistikë Goran Radunoviq shpjegoi se ka shqyrtuar të gjitha kërkesat që ka Agjencia dhe 737 mijë që janë për momentin dhe 2 milion 389 të mbetur do të vendosen jashtë evidencës së bilancit, të qëndrojnë por të mos tregohen në bilanc. Megjithatë, ai që do të jetë trashëgimtar dhe do të hyjë në Agjencion duhet të dijë se nga ku e ka origjinën kjo dhe nëse paguhet ndonjëherë të hiqet. Në lidhje me kërkesat e shumta, meqënëse kryhet arkëtim, duhet të qëndrojnë në bilansin e Agjencisë. Ndërsa për pjesën e mbetur prej 737 mijë denarë tha se dhe njëherë duhet të kontrolloj, nëse ekziston mundësi për arkëtim, sepse tani janë tek përmbaruesi, dhe do të vihen në evidencë jashtë bilancit ku të figurojnë për tu ditur origjina.

Z. Trajçevski tha se vërejtja e auditimit është vetëm për 1 milion dhe 652 mijë denarë. Agjencia për këtë nuk pajtohet sepse ka pagesë mujore nga debitori.

Këshilli i Agjencisë në lidhje me rezultatet nga auditimi i kryer për 2023 nga ana e Shoqërisë për revizion dhe biznes konsalting A&BA GROUP SHPKNJP Shkup njëzëri përcaktoi qëndrimin vijues të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale:

- Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, pajtohet me mendimin e dhënë nga Raporti i Auditimit për 2023, i vërtetuar në arkivin e Agjencisë nën numrin 02-1248/2 datë 18.03.2024, me përjashtim të mendimeve me rezervë të publikuara në shënimin 4 (që i referohen arkëtimeve të papaguara) dhe shënitimit 9 (që i referohet tokës nën ndërtesë), për arsye se vlera e tokës nën ndërtesë të Agjencisë është futur

në bilancin e Agjencisë me rekomandim të Entit Shtetëror për Revizion, ndërsa për kërkesën e Agjencisë në shumë prej 1 milion dhe 652 milion denarë, e cila është pjesë e kërkesës së papaguar, Agjencia ka arkëtimit mujor përmes përmbaruesit.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Qëndrimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Pika 5

Z. Petrushevski në lidhje me Propozim-udhëzimin për transmetuesit për Zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare 2024, tha se pika do të shtyhet për arsye që presin informacion plotësues nga Kuvendi, lidhur me vetë Udhëzimin. Udhëzimi do të vihet për miratim në vazhdim të seancës së 12-të në atë moment kur do të mirret përgjigje nga Kuvendi, dhe shpreson që kjo të jetë shumë shpejt.

Pika 6

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën, Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**